



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS  
KOMISIONI I ANKIMIT

Nr. 754/7 prot.

Tiranë, më 08.06.2026

VENDIM

Nr. 16 datë 08/06/2026

**“Për refuzimit e ankimit të organizatës jofitimprurëse “Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare” ndaj Vendimit të Komisionit të Vlerësimit Nr. 06, datë 14.05.2026, për refuzimin e aplikimit për përfitimin e financimeve nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti”**

Komisioni i Ankimit i përbërë prej:

**Z. Erjon Ndreca** - Kryetar  
**Znj. Sindi Prifti** - Anëtar  
**Znj. Arsilda Mamica** - Anëtar

asistuar nga Sekretariati Teknik, sot, me datë 08.06.2026, mori në shqyrtim ankimin administrativ, për refuzimin e aplikimit për përfitimin e financimeve nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, të organizatës “Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare”, depozituar pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas me datë 25.05.2026, Nr. 754/6 Prot, me të dhënat e mëposhtme:

**ANKUES:** “Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare”, përfaqësuar nga znj. Arta Dyrmishi, Drejtore Ekzekutive.

**OBJEKTI:** Ankimi ndaj Vendimit të Komisionit të Vlerësimit Nr. 06, datë 14.05.2026, administruar nga DNJF, me Nr. 754/6 Prot, datë 25.05.2026, “Për kërkesën për përfitim financimi të Organizatës Jofitimprurëse “Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare”.

**BAZA LIGJORE:** Ligji Nr. 111/2017, datë 14.12.2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;  
Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 110, datë 06.03.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”; (i ndryshuar me Ligjin nr. 124, datë 10.02.2026);  
Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF nr. 4, datë 07.01.2025, “Për miratimin e metodologjisë mbi procedurat e financimit të Organizatave Jofitimprurëse të Autorizuara nga Ministri i Drejtësisë”, (i ndryshuar me Urdhrin nr. 124, datë 10.02.2026).

Komisioni i Ankimit, pasi shqyrtoi pretendimet e ankuesit që ndër të tjera kërkon “*pranimin e ankesës dhe miratimin e përfitimit të financimit për projekt propozimin*”.

### VËREN SE:

Referuar dokumentacionit të përcjellë në aplikimin e Organizatës Jofitimprurëse “*Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare*”, rezulton se Komisioni i Vlerësimit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për financim të organizatave jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë, me Vendimin Nr. 06, datë 14.05.2026, **vendosi unanimitisht refuzimin e aplikimit për financim.**

Pranë Komisionit të Ankimit në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas me datë 25.05.2026, Nr. 754/6 Prot., është administruar ankimi i “*Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare*”, përfaqësuar nga znj. Arta Dyrmishi, Drejtore Ekzekutive.

Kundër Vendimit të Komisionit të Vlerësimit Nr. 06, datë 14.05.2026, në ankimin e saj me shkrim znj. Dyrmishi, përfaqësuese e “*Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare*”, ka parashtruar se:

- Përfashtimi konsiderohet i padrejtë pasi:
  1. Vlerësimi i Komisionit në drejtim të kapacitetit organizativ dhe burimeve njerëzore nuk është mbështetur në një metodologji të qartë dhe të argumentuar vlerësimi.
  2. Ambientet e zyrave të organizatës garantojnë zhvillimin e shërbimeve në kushte konfidencialiteti dhe ruajnë privatësinë e përfituesve të ndihmës juridike.
  3. Numri i rasteve të trajtuara nuk mund të merret si kriter referues për vlerësimin e kapaciteteve të organizatës, pasi deri më tani aktiviteti është zhvilluar kryesisht mbi bazën e punës vullnetare.
  4. Në projekt-propozimin e paraqitur është parashikuar angazhimi i një juristi me kohë të plotë (full-time), i cili do të sigurojë ofrimin e shërbimeve juridike sipas kërkesave të programit.

Në vijim të këtyre pretendimeve, ankuesi ka kërkuar “*pranimin e ankesës dhe miratimin e përfitimit të financimit për projekt propozimin*”.

### **Rrethanat faktike të çështjes**

Pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas është administruar kërkesa e organizatës jofitimprurëse “*Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare*” protokolluar me Nr. 754 Prot., datë 12.03.2026, Organizata Jofitimprurëse ka aplikuar për financim nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti.

Bazuar në kriteret e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 110, datë 06.03.2019, “*Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre*”, i ndryshuar si dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF nr. 4, datë 07.01.2025, “*Për miratimin e metodologjisë mbi procedurat e financimit të Organizatave Jofitimprurëse të Autorizuara nga Ministri i Drejtësisë*”, i ndryshuar me Urdhrit nr. 124, datë 10.02.2026, organizata ka përcjellë dokumentacionin i cili është marrë në shqyrtim nga Komisioni i Vlerësimit.

Komisioni i vlerësimit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për financim të organizatave jofitimprurëse të autorizuara ngritur me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 104, datë 19.02.2026, pasi mori në dorëzim dhe shqyrtoi dokumentacionin e përcjellë nga organizata, mbajti Relacionin nr. 754/1 prot., datë 01.04.2026 “Mbi kërkesën për financim nga organizata jofitimprurëse e autorizuar “Shoqata e të drejtave të Grave Rurale e Urbane (MDG) - Berat”. Në këtë relacion u evidentuan mangësitë në dokumentacionin e përcjellë të cilat përbëjnë shkak skualifikimi dhe komisioni në mënyrë unanime vendosi njoftimin e organizatës jofitimprurëse se komisioni do të vijojë me procedurën e verifikimit të kritereve, pas plotësimit të të metave, nëpërmjet dërgimit të dokumentacionit të poshtëshënuar brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit.

Me shkresën nr. 754/2 prot, datë 02.04.2026 me lajmërim marrje nga (RR814467948AA) të marrë nga Organizata jofitimprurëse “Shoqata etë drejtave të Grave Rurale e Urbane (MDG) - Berat” në datën 06.04.2026, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka kërkuar paraqitjen e dokumentacionit plotësues, si më poshtë:

1. Statuti i Shoqatës.
2. Akti i Themelimit të Organizatës Jofitimprurës të Autorizuar.
3. Certifikata e regjistrimit NIPT nr. serial 10131400002, origjinal ose i njehsuar me origjinalin
4. Autorizimi Prill 2025 nga Ministri i Drejtësisë, origjinal ose i njehsuar me origjinalin.
5. Vërtetim nga gjykata që organizata nuk është në proces falimentimi (i përditësuar);
6. Pasqyra financiare e vitit të fundit duhet të jenë të konfirmuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Referuar procesverbalit të mbledhjes së datës 14.05.2026, Komisioni i Vlerësimit, në zbatim të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ka vijuar procesin e vlerësimit të kërkesës për aplikim me pjesëmarrjen e katër anëtarëve të tij.

Me shkresën nr. 754/3 prot, datë 08.04.2026, Organizata jofitimprurëse “Shoqata etë drejtave të Grave Rurale e Urbane (MDG) - Berat” ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

1. Statuti i Shoqatës i njehsuar me origjinalin.
2. Për dokumentin “Akti i Themelimit” të Organizatës Jofitimprurëse të Autorizuar ka depozituar deklaratën ku shprehet se në kohën e krijimit të organizatës në vitin 1998 nuk ka patur Akt Themelimi për Organizatat jofitimprurëse dhe është bërë regjistrimi në vendimin nr. 218, datë 16.01.1998 të Gjykatës së Rrethit Berat.
3. Certifikata e regjistrimit NIPT nr. serial 10131400002, i njehsuar me origjinalin.
4. Autorizimi Prill 2025 nga Ministri i Drejtësisë, i njehsuar me origjinalin.
5. Vërtetim nga gjykata që organizata nuk është në proces falimentimi i përditësuar në datë 08.04.2026;
6. Pasqyra financiare të vitit 2025 të njehsuar me origjinalin dhe të konfirmuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se organizata ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar **brenda afatit ligjor prej 5 (pesë) ditësh nga marrja e njoftimit.**

Pas administrimit të dokumentacionit të plotë, në bazë të pikës 14/1 të VKM nr. 227, datë 23.04.2023, ku përcaktohet se: “Komisioni Vlerësues vlerëson përmbushjen e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta, bazuar në metodologjinë e miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas”,

Bazuar në këtë vlerësim, organizata jofitimprurëse “Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare” u pikëzua sipas tabelës TIP, duke marrë në total 9 pikë nga 50 pikë të mundshme.

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit ka dalë në përfundimin se:

Nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur nga organizata “Shoqata e të Drejtave të Grave Rurale dhe Urbane (MDG) – Berat”, si dhe nga përfundimi i procesit të pikëzimit, Komisioni vlerëson se kjo organizatë **nuk përmbush kriteret për përfitimin e financimit, për arsyet si më poshtë:**

1. Referuar listëpagesës së muajit janar 2026, të gjeneruar nga sistemi i tatimeve, rezulton se organizata ka të deklaruar vetëm një punonjës. Ky fakt nuk përmbush kërkesat e parashikuara në Metodologji lidhur me kapacitetet minimale njerëzore për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore, duke ndikuar drejtpërdrejt në vlerësimin e kriterit të kapacitetit organizativ dhe burimeve njerëzore.
2. Organizata nuk disponon ambiente të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, si dhe nuk garanton ambiente të veçuara për trajtimin e rasteve sensitive.
3. Evidentohet një numër i ulët i rasteve të ndihmës juridike parësore të raportuara pranë DNJF, konkretisht 46 raste për një periudhë 10-mujore, ndërkohë që targeti minimal, sipas metodologjisë përkatëse, është 50 raste në një periudhë 3-mujore. Ky fakt tregon mosarritje të standardeve minimale të performancës dhe ndikon në vlerësimin e eksperiencës dhe efektivitetit të organizatës.
4. Në formularin tip të aplikimit për projekt-propozimin, organizata nuk ka paraqitur një përshkrim të detajuar të projektit, në veçanti lidhur me numrin e rasteve që synon të trajtojë në kuadër të ndihmës juridike parësore. Gjithashtu, mungon një shpjegim i qartë mbi mënyrën e përlllogaritjes së pagës së juristit dhe kohëzgjatjen e angazhimit në orë pune. Paga e deklaruar për juristin nuk është në përputhje me vlerën totale të financimit të kërkuar nga organizata. Nga shqyrtimi i formularit tip të aplikimit dhe projekt-propozimit të paraqitur nga organizata, Komisioni Vlerësues konstaton se dokumentacioni nuk përmbush standardet minimale të kërkuara nga Metodologjia mbi përmbajtjen dhe strukturën e projekt-propozimeve, duke paraqitur mangësi thelbësore si në aspektin përshkrues, ashtu edhe në atë financiar dhe operacional.

Në tërësi, këto mangësi bëjnë që projekt-propozimi të mos ofrojë një bazë të mjaftueshme për të vlerësuar nëse organizata është në gjendje të realizojë në mënyrë efektive dhe cilësore shërbimin e ndihmës juridike parësore, në përputhje me qëllimin e financimit të ofruar nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas.

Për rrjedhojë, projekt-propozimi vlerësohet si **i paplotë, jo i detajuar dhe jo i zbatueshëm**, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në uljen e pikëzimit dhe në moskualifikimin e organizatës për përfitimin e financimit.

**Vlerësimi i Komisionit të Ankimit mbi procedurat e ndjekura në kuadër të aplikimit të “Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare”, për përfitimin e financimeve nga buxheti i shtetit.**

Në mbështetje të pikës 5 të VKM nr. 110, datë 6.3.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka ndërmarrë masat për publikimin në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të thirrjes për financimin e OJF-ve të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore (Afati i aplikimit 16.02.2026 - 16.03.2026):

- Buletini nr. 4, viti 2026: <https://qbz.gov.al/eli/bnjz/2026/4/0cdd63ac-bd59-4aec-ac66-232c3546e049;q=P%C3%ABr%20shpalljen%20e%20thirrjes%20p%C3%ABr%20financi min%20e%20OJF-ve%20t%C3%AB%20autorizuara%20p%C3%ABr%20ofrimin%20e%20Ndhm%C3%ABs%20Juridike%20Par%C3%ABsore.%20viti%202026%F2%80%9D>.

Gjithashtu, thirrja për financim është publikuar edhe në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, në rubrikën njoftime, si vijon:

link: <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/neesroom/njoftime/>

Në këtë kuadër me qëllim trajtimin e aplikimeve të paraqitura në afatet e mësipërme, në zbatim të VKM Nr. 110, datë 06.03.2019 i ndryshuar, me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë Nr. 104 Prot., datë 11.02.2026, u ngrit Komisioni i Vlerësimit dhe i Ankimit.

Pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas është administruar kërkesa e organizatës jofitimprurëse “*Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare*”, protokolluar me Nr. 754 Prot., datë 12.03.2026, e cila rezultoi e autorizuar nga Ministri i Drejtësisë. Kjo kërkesë rezultoi e paraqitur brenda afatit të thirrjes (***Afati i aplikimit 16.02.2026 - 16.03.2026***).

Në vijim të trajtimit të këtij aplikimi, me Vendimin Nr. 6, datë 14.05.2026, Komisioni i Vlerësimit refuzoi aplikimin e organizatës jofitimprurëse “*Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare*”.

Vendimi Nr. 6 datë 14.05.2026, iu komunikua organizatës nëpërmjet shërbimit postar. Sipas informacionit të marrë pranë shërbimit postar, organizatës i është komunikuar vendimi me datë 18.05.2026.

Me shkresën e protokolluar pranë Drejtorisë me Nr. 754/6 Prot., datë 25.05.2026 organizata ka ushtruar të drejtën e ankimit dhe ka depozituar pranë postës në datë 22.05.2026. **Ky ankim, është bërë brenda afatit pesë ditor të parashikuar në pikën 16 të VKM-së Nr. 110, datë 06.03.2019 i ndryshuar.**

Komisioni i Ankimit duke u bazuar në procedurat e mësipërme, mbi dokumentacionin e depozituar nga organizata, parashtrimet e paraqitura në ankim, dhe vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit, konstaton se:

Bazuar në Pikën 2, të VKM Nr. 110, datë 06.03.2019, “*Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre*”, i ndryshuar rezultoi se procedurat e përfitimit të financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara janë bërë duke u bazuar në parimet:

- a) konkurrueshmërisë;
- b) trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara, që paraqesin kërkesën për përfitimin e financimit;
- c) transparencës të të gjitha fazave që lidhen me shqyrtimin, vendimmarrjen dhe përzgjedhjen e organizatave jofitimprurëse të autorizuara;
- ç) kritereve të mirëpërcaktuara dhe publike, të cilat do të mundësojnë vlerësimin e propozimeve të organizatave jofitimprurëse të autorizuara në raport me objektivat dhe prioritetet e mbështetjes financiare;
- d) efektivitetit dhe ekonomizimit në shfrytëzimin e fondeve publike, duke siguruar që të arrihen

objektivat dhe prioritetet e përcaktuara me një kosto sa më të favorshme për realizimin e shërbimit të synuar;

dh) respektimit të plotë të parimeve të llogaridhënies dhe raportimit në përdorimet e fondeve publike;

e) financimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore për kategoritë e përfitueseve që janë me prioritet për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas dhe në interes të përfituesve të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti;

ë) ruajtjes së pavarësisë së organizatës jofitimprurëse të autorizuar;

f) parandalimit të konfliktit të interesit, si dhe të çdo aktiviteti tjetër që rrezikon ofrimin me integritet të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Në Pikën 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 110, datë 06.03.2019 i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: *“Për t’u kualifikuar për të përfituar financime, organizatat jofitimprurëse të autorizuar duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, përfshirë këtu edhe kërkesa të tjera specifike që mund të jenë të nevojshme për ofrimin e ndihmës juridike parësore, sipas thirrjes publike të veçantë”*.

Këto kërkesa specifike janë përcaktuar në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF nr. 4, datë 07.01.2025, *“Për miratimin e metodologjisë mbi procedurat e financimit të Organizatave Jofitimprurëse të Autorizuara nga Ministri i Drejtësisë”*, (i ndryshuar me Urdhrin nr. 124, datë 10.02.2026), të cilat lidhen me prioritetet e kërkuara dhe targetin për secilin prioritet.

Evidentohet se organizata, në përputhje me Pikën 6 të VKM-së nr. 110, datë 06.03.2019, *“Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”*, i ndryshuar, ka depozituar dokumentacionin e kërkuar, referuar të cilit Komisioni i Vlerësimit, në analizë përmbajtëse, ka konkluduar se duke marrë në konsideratë mangësitë e konstatuara në kapacitetet njerëzore dhe infrastrukturore të organizatës, numrin e ulët të rasteve të ndihmës juridike parësore të raportuara pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, si dhe mangësitë e evidentuara në formularin e aplikimit dhe projekt-propozimin e paraqitur, rezulton se organizata jofitimprurëse dhe projekti i paraqitur nuk plotësojnë kriteret e nevojshme për t’u kualifikuar për financim dhe, për rrjedhojë, kërkesa për financim refuzohet.

**Konkretisht, referuar Vendimit të Komisionit të Vlerësimit rezulton se bazuar në relacionin arsyetues Nr.754/4 Prot. Datë 14.05.2026, arsyet e skualifikimit të organizatës “Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare”, janë:**

1. Referuar listëpagesës së muajit janar 2026, të gjeneruar nga sistemi i tatimeve, rezulton se organizata ka të deklaruar vetëm një punonjës. Ky fakt nuk përmbush kërkesat e parashikuara në Metodologji lidhur me kapacitetet minimale njerëzore për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore, duke ndikuar drejtpërdrejt në vlerësimin e kriterit të kapacitetit organizativ dhe burimeve njerëzore.
2. Organizata nuk disponon ambiente të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, si dhe nuk garanton ambiente të veçuara për trajtimin e rasteve sensitive.
3. Evidentohet një numër i ulët i rasteve të ndihmës juridike parësore të raportuara pranë DNJF, konkretisht 14 raste për një periudhë 9-mujore, ndërkohë që targeti minimal, sipas metodologjisë përkatëse, është 50 raste në një periudhë 3-mujore. Ky fakt tregon mosarritje të standardeve minimale të performancës dhe ndikon në vlerësimin e eksperiencës dhe efektivitetit të organizatës.

4. Në formularin tip të aplikimit për projekt-propozimin, organizata nuk ka paraqitur një përshkrim të detajuar të projektit, në veçanti lidhur me numrin e rasteve që synon të trajtojë në kuadër të ndihmës juridike parësore. Gjithashtu, mungon një shpjegim i qartë mbi mënyrën e përlllogaritjes së pagës së juristit dhe kohëzgjatjen e angazhimit në orë pune. Paga e deklaruar për juristin nuk është në përputhje me vlerën totale të financimit të kërkuar nga organizata. Nga shqyrtimi i formularit tip të aplikimit dhe projekt-propozimit të paraqitur nga organizata, Komisioni Vlerësues konstaton se dokumentacioni nuk përmbush standardet minimale të kërkuara nga Metodologjia mbi përmbajtjen dhe strukturën e projekt-propozimeve, duke paraqitur mangësi thelbësore si në aspektin përshkrues, ashtu edhe në atë financiar dhe operacional.

**Për sa më sipër, Komisioni i Ankimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar në dosje, pretendimeve të ngritura në ankim dhe arsytimit të Komisionit të Vlerësimit, vlerëson se:**

Lidhur me pikën 1, Komisioni i Ankimit vlerëson se fakti që organizata ka të deklaruar vetëm një punonjës nuk përbën shkak për skualifikimin e aplikimit. Referuar Metodologjisë, kriteret që lidhen me kapacitetin organizativ dhe burimet njerëzore ndikojnë në vlerësimin dhe pikëzimin e aplikimit, por nuk janë parashikuar si kriterë skualifikues. Gjithashtu, Komisioni i Ankimit konstaton se punonjësi i deklaruar është vlerësuar pozitivisht nga vetë Komisioni i Vlerësimit për sa i përket kualifikimeve dhe eksperiencës profesionale. Për rrjedhojë, ky element mund të ndikojë në pikëzimin e aplikimit, por nuk mund të shërbejë si bazë për skualifikimin e organizatës.

Lidhur me pikën 2, Komisioni i Ankimit vlerëson se Komisioni i Vlerësimit me të drejtë ka konstatuar se Organizata nuk disponon ambiente të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, si dhe nuk garanton ambiente të veçuara për trajtimin e rasteve sensitive. Vetë organizata në ankimin e paraqitur deklaron mungesën e ambienteve të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, duke e relativizuar rëndësinë e këtij kriteri me alternativa të mundshme realizimi të qëllimit në rast financimi duke marrë si shembull vajtjen në adresën e personit që kërkon ndihmë.

Referuar VKM 110/2019, pikës 6, gërma b/IV, për t'u kualifikuar për të përfituar financim, organizata duhet të plotësoj kriteret e përgjithshme dhe të veçanta ku ndër kriteret e veçanta parashikohet kriterë specifike të cilat mund të jenë të nevojshme për ofrimin e ndihmës juridike parësore sipas thirrjes publike të veçantë. Pjesë e thirrjes është zbatimi i Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF nr. 4, datë 07.01.2025, "Për miratimin e metodologjisë mbi procedurat e financimit të Organizatave Jofitimprurëse të Autorizuara nga Ministri i Drejtësisë", (i ndryshuar me Urdhrin nr. 124, datë 10.02.2026). Konkretisht, në pikën 3 të seksionit të kriterëve të veçanta citohen aktivitet (asetet) afatgjata të organizatës, ku kërkohen dokumentet të cilat vërtetojnë faktin se vendndodhja e organizatës është lehtësisht e aksesueshme nga qytetarët (e pajisur me rampë ose ashensor) përbën një kriter skualifikues. Nga ana e organizatës edhe nëpërmjet fotove të dorëzuara në aplikim, edhe nëpërmjet ankesës vërtetohet mungesa e rampës. Sa më sipër komisioni i Ankimit vlerëson se Komisioni i Ankimit me të drejtë ka vendosur refuzimin e kërkesës për përfitim financimi të Shoqatës Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare.

Lidhur me pikën 3, Komisioni i Ankimit vlerëson se numri i rasteve të ndihmës juridike parësore të trajtuara dhe të raportuara gjatë vitit të mëparshëm nuk përbën kriter skualifikues në projekt-propozimin e paraqitur në kuadër të thirrjes së financimit për vitin aktual. Procesi i vlerësimit duhet të fokusohet në kapacitetin e organizatës për të realizuar aktivitetet e propozuara dhe për të arritur objektivat e parashikuara në projektin për të cilin kërkohet financimi. Në këtë kuadër, elementi që duhet të merret në konsideratë është numri i rasteve dhe aktivitetet që organizata ka planifikuar të trajtojë gjatë periudhës së financimit për të cilën aplikon, dhe jo performanca e saj gjatë një periudhe të mëparshme.

Lidhur me pikën 4, Komisioni i Ankimit vlerëson se Komisioni i Vlerësimit ka vepruar drejt kur ka konstatuar mangësi në formularin tip të aplikimit dhe në projekt-propozimin e paraqitur nga organizata. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se formulari nuk është plotësuar në mënyrë të plotë dhe të qartë, pasi mungojnë elementë thelbësorë për vlerësimin e projektit, si numri i rasteve që synohen të trajtohen në kuadër të ndihmës juridike parësore, mënyra e përlllogaritjes së pagës së juristit, si dhe kohëzgjatja e angazhimit të tij në orë pune. Gjithashtu, informacioni i paraqitur në buxhet dhe në përshkrimin e projektit nuk mundëson një kuptim të qartë të mënyrës së përdorimit të fondeve të kërkuara dhe të lidhjes së tyre me aktivitetet e propozuara. Këto mangësi cenojnë transparencën dhe verifikueshmërinë e projekt-propozimit, duke e bërë të pamundur një vlerësim të plotë dhe objektiv të tij. Për rrjedhojë, Komisioni i Ankimit vlerëson se konstatimet e Komisionit të Vlerësimit mbi paplotësinë dhe paqartësinë e formularit tip të aplikimit janë të bazuara dhe në përputhje me kërkesat e Metodologjisë për përmbajtjen dhe strukturën e projekt-propozimeve.

**Për sa më sipër, Komisioni i Ankimit vlerëson se arsyet e refuzimit të kërkesës për përfitimin e financimit (konkretisht pika 2 dhe 4) të paraqitura nga Komisioni i Vlerësimit mbështeten në mënyrë të mjaftueshme në kriteret dhe metodologjinë e financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara.**

### PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Ankimit, duke marrë në konsideratë ankimin e depozituar nga **“Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare”**, mbështetur në rrethanat e faktit, si dhe dokumentacionin e administruar Komisioni i Ankimit konstaton se Vendimi i Komisionit të Vlerësimit Nr. 06, datë 14.05.2026, është në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 110, datë 06.03.2019, *“Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”*; Rregulloren *“Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”*, të miratuar me Urdhrin e Ministrit Nr. 393, datë 23.11.2020, dhe Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF nr. 4, datë 07.01.2025, *“Për miratimin e metodologjisë mbi procedurat e financimit të Organizatave Jofitimprurëse të Autorizuara nga Ministri i Drejtësisë”*, (i ndryshuar me Urdhrin nr. 124, datë 10.02.2026).

Në këto rrethana, bazuar në Pikat 16, 17 dhe 18, VKM Nr. 110, *“Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”*, Komisioni i Ankimit unanimisht:

### VENDOSI:

1. Refuzimin e ankimit të paraqitur nga Organizata Jofitimprurëse **“Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare”**.
2. Kopje e këtij vendimi t’i njoftohet Organizatës jo më vonë se dy ditë nga marrja e vendimit.
3. Ngarkohet Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas për njoftimin dhe publikimin e këtij vendimi sipas parashikimeve ligjore.

4. Kundër këtij vendimi ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative kompetente, brenda afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

**KRYETAR**

**Erjon Ndreca**



**ANËTAR**  
**Sindi Prifti**



**ANËTAR**  
**Arsilda Mamica**



U shpall në Tiranë,  
me datë 08.06.2026.  
Ky vendim hartohet në 5 (pesë) kopje.